



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i zbatimit të
Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
për vitin 2024

Tetor, 2025

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
Koordinimi dhe monitorimi i projekteve.....	6
RAPORTI PËRMBLEDHËS	8
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Qendër	15
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Veri.....	16
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Perëndim	17
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Jug	17
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Juglindje.....	18
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Lindje	19
Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Jugperëndim.....	20
Përfundimi	22

Lista e tabelave

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara	7
Tabela 2: Shpërndarja fillestare e përfituesve dhe shumave të përfituara nga MZHR sipas rajoneve zhvillimore dhe kategorive të projekteve në kuadër të PZHRB 2024	8
Tabela 3: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2024, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore	9
Tabela 4: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2024, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas kategorive ekonomike	10
Tabela 5: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start-Up (Studentët), nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	11
Tabela 6: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start Up, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore	12
Tabela 7: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	13
Tabela 8: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	14
Tabela 9: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor: Qendër sipas kategorive biznesore	15
Tabela 10: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor: Veri sipas kategorive biznesore ...	16
Tabela 11: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Perëndim sipas kategorive biznesore	17
Tabela 12: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Jug sipas kategorive biznesore.....	18
Tabela 13: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Juglindje sipas kategorive biznesore	19
Tabela 14: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Lindje sipas kategorive biznesore.	20
Tabela 15: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Jugperëndim sipas kategorive biznesore	21

Lista e figurave

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHRB-së.....	9
Figura 2: Ndarja e projekteve të mbështetura sipas sektorëve ekonomikë.....	10
Figura 3: Pjesëmarrja e kategorive ekonomike në mbështetjen financiare të PZHRB-së.....	11
Figura 4: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Start-Up për studentët të PZHRB-së.....	12
Figura 5: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Start-Up të PZHRB-së.....	13
Figura 6: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Lot 1: Biznese ekzistuese të PZHRB-së.....	14
Figura 7: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Lot 2: Biznese ekzistuese të PZHRB-së.....	15
Figura 8: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Qendër	16
Figura 9: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Veriu.....	16
Figura 10: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Perëndim.....	17
Figura 11: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Jug	18
Figura 12: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Juglindje.....	19
Figura 13: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Lindje	20
Figura 14: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Jugperëndim	21

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

HYRJE

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar mbetet një ndër shtyllat kryesore të politikave të Qeverisë për zhvillimit rajonal të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë ndërmjet rajoneve të ndryshme të vendit, duke përfshirë sektorin e prodhimit, përpunimit dhe shërbimeve.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes këtij programi, vazhdon të jetë e përkushtuar në mbështetjen e projekteve të qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, duke kontribuar në fuqizimin e tyre ekonomik, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e aftësive menaxheriale për një ndërmarrësi të qëndrueshme. Gjithashtu, programi ka inkurajuar aplikime nga të rinjtë me ide inovative, si dhe nga përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 ishte rreth 1.3 milionë euro, i cili u shfrytëzua për të mbështetur si bizneset ekzistuese, ashtu edhe nismat e reja sipërmarrëse. Bizneset ekzistuese përfituan për të zgjeruar veprimtarinë e tyre, ndërsa Start-Up-et u mbështetën në realizimin e planeve të tyre për fillimin e biznesit.

Synimet specifike të kësaj mbështetje financiare për vitin 2024 ishin:

- ✓ Përkrahja e bizneseve të reja dhe zhvillimi i bizneseve me potencial rritjeje;
- ✓ Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve;
- ✓ Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në rritjen e eksportit;
- ✓ Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë.

Për herë të parë këtë vit, programi përfshiu edhe mbështetje për *Start-Up-e të udhëhequra nga studentë*, krahas kategorive tradicionale si:

- Start-Up-e,
- Lot 1 (me qarkullim nga 5,000.00€ deri në 50,000.00€), dhe
- Lot 2 (me qarkullim nga 30,000.00€ deri në 300,000.00€).

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024 përmbledh rezultatet dhe ndikimin e mbështetjes financiare në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës, sipas Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Nenit 16.

Gjatë vitit 2024, programi ka financuar 186 përfitues me mbi 2.5 milion euro nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, ndërsa përfituesit kanë kontribuar me mbi 721 mijë euro, duke arritur një total investimesh mbi 3.2 milion euro nëpër rajonet zhvillimore të vendit.

Këto investime kanë krijuar 422 vende të reja pune, duke ndikuar pozitivisht në tregun lokal të punës, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë. Rajoni zhvillimor Qendër ka pasur numrin më të madh të përfituesve (36) dhe një kontribut prej mbi 626 mijë euro, me 81 vende të reja pune, ndërsa rajoni zhvillimor Juglindje ka mbështetur 19 projekte me mbi 384 mijë euro dhe 54 vende të reja pune.

Programi ka përkrahur bizneset e reja dhe ekzistuese, me fokus në gratë, të rinjtë dhe komunitetet jo shumicë.

Koordinimi dhe monitorimi i projekteve

MZHR me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të programit ka caktuar monitorues, në shtatë rajone zhvillimore, si:

1. Kreshnike Arifi, *Monitoruese për rajonin zhvillimor: 07 - Jugperëndim;*
2. Hashim Ibishi, *Monitorues për rajonin zhvillimor: 02 - Veri, 03 - Perëndim, dhe 06 - Lindje*
3. Gresa Gashi, *Monitoruese për rajonin zhvillimor: 05 - Juglindje;*
4. Aridon Morina, *Monitorues për rajonin zhvillimor: 01 - Qendër dhe 04 - Jug;*

Zyrtarët monitorues kanë realizuar monitorimet në vendin e ngjarjes, tek bizneset përfituese, ku nga afër kanë parë pajisjet dhe funksionalitetin e biznesit dhe pas verifikimit të gjendjes në terren dhe verifikimit të dokumenteve të listës së punëtorëve (sipas deklarimit në aplikacion) përfituesit i është proceduar edhe pjesa e dytë e pagesës nga mjetet e përfituara.

Në tabelën më poshtë po i prezantojmë të dhënat e monitorimeve sipas rajonit, lot-eve dhe numrit të monitorimeve sipas secilit zyrtar monitorues veç e veç.

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara

Zyrtari monitorues	Rajoni zhvillimor	Start Up - Studentët	Start Up	Lot 1	Lot 2	Gjithsej
Aridon Morina	01 Qendër	3	12	14	8	36
	04 Jug	-	10	18	6	34
Hashim Ibishi	02 Veri	-	12	11	5	28
	03 Perëndim	-	9	7	6	22
	06 Lindje	1	10	10	5	26
Gresa Gashi	05 Juglindje	-	7	5	7	19
Kreshnike Arifi	07 Jugperëndim	-	6	10	5	21
Totali:		4	65	75	42	186

Procesi i monitorimi të projekteve të financuara nga thirrja për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2024, sikurse edhe në të kaluarën, ka hasur në disa sfida kryesore, duke përfshirë: kapacitetet e kufizuara të monitorimit, vonesat në implementim të projektit dhe vështirësitë e matjes së ndikimit të drejtpërdrejtë.¹

¹ Për shkak të këtyre sfidave që janë hasur gjatë procesit të monitorimit është vonuar grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave si dhe hartimi i raportit të zbatimit të PZHRB për vitin 2024.

RAPORTI PËRMBLEDHËS

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024, i menaxhuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), synon të mbështesë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe të balancuar në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës, duke fuqizuar bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të promovimit të kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese, si dhe duke krijuar vende të reja pune.

Gjatë vitit 2024, PZHRB mbështeti gjithsej 199 projekte, nga të cilat 186 janë zbatuar me sukses në shtatë rajone zhvillimore të Kosovës. Investimi total i realizuar arrin mbi 3.2 milionë euro, ku 2.5 milionë euro janë financuar nga MZHR dhe rreth 721 mijë euro janë kontribuar nga përfituesit. Ky investim ka krijuar 422 vende të reja pune, duke ndikuar në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe në uljen e papunësisë në rajonet më të prekura.

Gjatë zbatimit, 13 projekte u tërhoqën për arsye personale, familjare ose për shkak të vazhdimit të studimeve jashtë vendit. Gjithashtu, MZHR ndërpreu një kontratë për shkak të mosrespektimit të kushteve të saj, ndërsa një rast tjetër është dërguar në gjykatë për mosrespektim të afateve dhe detyrimeve kontraktuale.

Në vazhdim, paraqitet shpërndarja fillestare e përfituesve dhe shumave të financuara sipas rajoneve dhe kategorive të projekteve, si dhe ndikimi i tyre në tregun e punës.

Tabela 2: Shpërndarja fillestare e përfituesve dhe shumave të përfituara nga MZHR sipas rajoneve zhvillimore dhe kategorive të projekteve në kuadër të PZHRB 2024

Rajoni zhvillimor	Start Up - Studentët		Start Up		Lot 1		Lot 2		Gjithsej	
	Nr. i përfit.	Shuma e përfit. (€)	Nr. i përfit.	Shuma e përfit. (€)	Nr. i përfit.	Shuma e përfit. (€)	Nr. i përfit.	Shuma e përfit. (€)	Nr. i përfit.	Shuma e përfit. (€)
01 Qendër	4	15,004.60	13	60,672.85	14	196,747.40	8	227,700.00	39	500,124.85
02 Veri	-	-	12	57,672.50	11	150,569.42	5	134,880.00	28	343,121.92
03 Perëndim	-	-	9	42,262.00	7	96,400.00	6	173,800.00	22	312,462.00
04 Jug	-	-	14	66,059.00	19	247,576.40	6	155,098.40	39	468,733.80
05 Juglindje	-	-	8	36,597.88	5	70,350.00	7	184,638.75	20	291,586.63
06 Lindje	1	4,945.00	11	54,800.00	10	130,492.50	5	183,500.00	27	373,737.50
07 Jugperëndim	-	-	8	37,396.26	10	143,868.40	6	175,712.50	24	356,977.16
Totali:	5	19,949.60	75	355,460.49	76	1,036,004.12	43	1,235,329.65	199	2,646,743.86


Në tabelën 3 paraqitet shpërndarja e mjeteve financiare të realizuara nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024, sipas rajoneve zhvillimore. Në total janë mbështetur 186 projekte në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, të cilat kontribuan në krijimin e 427 vendeve të reja pune.

Tabela 3: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2024, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Rajoni zhvillimor</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
01 Qendër	36	488,904.85	137,562.91	626,467.76	81
02 Veri	28	343,121.92	80,753.17	423,875.09	69
03 Perëndim	22	312,462.00	108,199.00	420,661.00	49
04 Jug	34	435,083.80	124,812.43	559,896.23	76
05 Juglindje	19	286,836.95	97,379.05	384,216.00	54
06 Lindje	26	324,737.50	79,872.50	404,610.00	48
07 Jugperëndim	21	318,060.90	92,443.96	410,504.86	50
Totali:	186	2,509,207.92	721,023.02	3,230,230.94	427


Pjesëmarrja e secilit rajon në shumën totale të mbështetjes financiare është pasqyruar në figurën 1. Rajoni zhvillimor Qendër ka përfituar 20% të fondeve, i ndjekur nga rajonet zhvillimore: Jug me 17%, Lindje dhe Jugperëndim me nga 13%, Perëndim me 12%, dhe Juglindje me 11%.

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHRB-së



Grafiku më poshtë paraqet sektorët më të përfaqësuar në projektet e financuara përmes PZHRB 2024 në të gjitha rajonet zhvillimore. Më së shumti janë mbështetur bizneset në fushën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, të cilat përfaqësojnë sektor me potencial të lartë punësimi dhe ndikimi ekonomik lokal.

Figura 2: Ndarja e projekteve të mbështetura sipas sektorëve ekonomikë



Nga projektet përfituese, shpërndarja sipas sektorëve ishte **49%** e projekteve, përkatësisht 92 projekte, i përkisnin **sektorit të shërbimeve**; **45%**, ose 84 projekte, ishin të orientuara drejt **sektorit të prodhimit**; **ndërsa 5%**, që përbëjnë 10 projekte, i përkisnin **sektorit të përpunimit**.

Mbështetja financiare, në kuadër të PZHRB për vitin 2024, është shpërndarë në kategoritë: Start-Up për studentët, Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë të bizneseve mikro dhe të vogla në rajonet zhvillimore të Kosovës.


Tabela më poshtë paraqet numrin e përfituesve, kontributin financiar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR), kontributin e përfituesve, shumën totale të projektit si dhe numrin e vendeve të reja të punës të krijuara në secilën kategori. Kjo pasqyron qartë rëndësinë dhe përmasat e mbështetjes për secilin sektor, si dhe ndikimin konkret në krijimin e vendeve të reja të punës.

Tabela 4: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2024, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas kategorive ekonomike

Lot	Nr. i përfituesve	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projektit	Nr. të punësuarve
<i>Start Up - Student</i>	4	17,169.60	-	17,169.60	7
<i>Start Up</i>	65	308,104.55	27,478.22	335,582.77	108
<i>Lot 1</i>	75	1,022,104.12	236,956.53	1,259,060.65	172
<i>Lot 2</i>	42	1,161,829.65	456,588.27	1,618,417.92	140
Totali:	186	2,509,207.92	721,023.02	3,230,230.94	427

Për më tepër, grafiku i bashkëngjitur më poshtë ilustron pjesëmarrjen relative të secilës kategori në totalin e mbështetjes financiare të dhënë nga MZHR, duke ndihmuar në kuptimin e përqendrimit të fondeve në sektorët me potencialin më të madh zhvillimor dhe ekonomik.

Figura 3: Pjesëmarrja e kategorive ekonomike në mbështetjen financiare të PZHRB-së



Për herë të parë në kuadër të PZHRB 2024, MZHR mbështeti kategorinë Start-Up për studentët, duke ndarë rreth 17 mijë euro, që përfaqëson 0.7% të buxhetit të përgjithshëm të programit.


Në këtë kategori përfituan katër studentë nga dy rajone zhvillimore: Qendra dhe Lindja, të cilët realizuan projektet e tyre pa kërkesë për bashkëfinancim. Përmes kësaj mbështetjeje, studentët patën mundësi të zhvillojnë idetë e tyre sipërmarrëse, të vetëpunësohen dhe në disa raste, të punësojnë edhe bashkë studentë të tjerë.

Tabela 5: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start-Up (Studentët), nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Rajoni zhvillimor</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
01 Qendër	3	12,224.60	-	12,224.60	6
02 Veri	-	-	-	-	-
03 Perëndim	-	-	-	-	-
04 Jug	-	-	-	-	-
05 Juglindje	-	-	-	-	-
06 Lindje	1	4,945.00	-	4,945.00	1
07 Jugperëndim	-	-	-	-	-
Totali	4	17,169.60	-	17,169.60	7

Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare për kategorinë Start-Up për studentët është paraqitur në figurën 2. Në këtë kategori kishte përfitues nga vetëm dy rajone zhvillimore, Qendër dhe Lindje. Përmes kësaj kategorie, studentëve përveç që iu mundësua të jetësojnë idenë e tyre sipërmarrëse dhe të vetëpunësohen, disa prej tyre arritën që të punësojnë edhe studentë të tjerë.

Figura 4: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Start-Up për studentët të PZHRB-së



Në kategorinë Start-Up u mbështetën gjithsej 65 projekte nga të gjitha shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës.


Tabela 6 më poshtë paraqet shpërndarjen e përfituesve, kontributin e MZHR dhe të përfituesve, si dhe numrin e vendeve të reja të punës të krijuara sipas rajoneve.

Tabela 6: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start Up, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

PZHRB 2024, Start Up	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfituesve	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projektit	Nr. të punësuarve
	01 Qendër	11	52,232.85	4,662.13	56,894.98	18
	02 Veri	12	57,672.50	4,533.50	62,206.00	15
	03 Perëndim	9	42,262.00	3,654.00	45,916.00	18
	04 Jug	10	46,309.00	4,124.93	50,433.93	15
	05 Juglindje	7	31,848.20	3,167.80	35,016.00	19
	06 Lindje	10	49,800.00	4,845.00	54,645.00	14
	07 Jugperëndim	6	27,980.00	2,490.86	30,470.86	9
	Totali	65	308,104.55	27,478.22	335,582.77	108

Sipas të dhënave, rajoni Verior kryeson me 19% të mbështetjes totale në këtë kategori, i ndjekur nga Qendra (17%) dhe Lindja (16%). Rajonet me mbështetjen më të ulët ishin Juglindja (10%) dhe Jugperëndimi (9%). Figura 3 paraqet pjesëmarrjen e secilit rajon në përkrahjen financiare për kategorinë Start-Up.

Figura 5: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Start-Up të PZHRB-së



Kategoria Lot 1 – Biznese ekzistuese ka numrin më të madh të përfituesve në kuadër të PZHRB 2024, me gjithsej 75 projekte të mbështetura. Për këtë kategori janë ndarë mbi 1 milion euro nga MZHR, që përbëjnë 40.7% të shumës së përgjithshme të financimit, dhe janë krijuar 172 vende të reja pune.


Tabela 7 paraqet shpërndarjen e përfituesve, kontributin financiar dhe numrin e të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.

Tabela 7: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

PZHRB 2024, Lot 1	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfituesve	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projektit	Nr. të punësuarve
	01 Qendër	14	196,747.40	31,873.36	228,620.76	38
	02 Veri	11	150,569.42	36,799.67	187,369.09	29
	03 Perëndim	7	96,400.00	25,115.00	121,515.00	13
	04 Jug	18	233,676.40	62,058.40	295,734.80	36
	05 Juglindje	5	70,350.00	20,167.00	90,517.00	10
	06 Lindje	10	130,492.50	31,027.50	161,520.00	19
	07 Jugperëndim	10	143,868.40	29,915.60	173,784.00	27
	Totali	75	1,022,104.12	236,956.53	1,259,060.65	172

Siç shihet në Figurën 6, pjesëmarrja rajonale në mbështetjen për këtë kategori është e balancuar, me mbështetje më të lartë në rajonet Qendër, Jug dhe Veri.

Figura 6: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Lot 1: Biznese ekzistuese të PZHRB-së



Kategoria Lot 2 – Biznese ekzistuese është mbështetur nga MZHR me mbi 1.1 milion euro, që përfaqëson 46.3% të fondit të përgjithshëm të PZHRB 2024. Brenda kësaj kategorie janë përfshirë 42 projekte, me një mesatare prej rreth 6 përfituesish për rajon.


Gjatë zbatimit të projekteve, janë krijuar gjithsej 140 vende të reja pune. Rajonet me numrin më të lartë të të punësuarve janë Veriu, Jugu dhe Juglindja, secili me nga 25 punëtorë të rinj, ndërsa rajonet me më së paku janë Lindja dhe Jugperëndimi, me nga 14 punëtorë.

Tabela 8 paraqet detajet për ndarjen e mjeteve financiare dhe numrin e të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore. Pjesëmarrja e secilit rajon në fondin total për Lot 2 është vizualizuar në Figurën 7.

Tabela 8: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

PZHRB 2024, Lot 2	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfituesve	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projektit	Nr. të punësuarve
	01 Qendër	8	227,700.00	101,027.42	328,727.42	19
	02 Veri	5	134,880.00	39,420.00	174,300.00	25
	03 Perëndim	6	173,800.00	79,430.00	253,230.00	18
	04 Jug	6	155,098.40	58,629.10	213,727.50	25
	05 Juglindje	7	184,638.75	74,044.25	258,683.00	25
	06 Lindje	5	139,500.00	44,000.00	183,500.00	14
	07 Jugperëndim	5	146,212.50	60,037.50	206,250.00	14
	Totali	42	1,161,829.65	456,588.27	1,618,417.92	140

Figura 7: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare për kategorinë Lot 2: Biznese ekzistuese të PZHRB-së



Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Qendër

Rajoni zhvillimor Qendër përfitoi 19% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur 36 projekte në kuadër të katër kategorive: Start-Up Student, Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në këtë rajon është mbi 626 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 488 mijë euro janë financuar nga MZHR (78%),
- ndërsa mbi 137 mijë euro janë kontribuar nga vetë përfituesit (22%).

Tabela 9: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor: Qendër sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up - Student</i>	3	12,224.60	-	12,224.60	6
<i>Start Up</i>	11	52,232.85	4,662.13	56,894.98	18
<i>Lot 1</i>	14	196,747.40	31,873.36	228,620.76	38
<i>Lot 2</i>	8	227,700.00	101,027.42	328,727.42	19
<i>Totali:</i>	36	488,904.85	137,562.91	626,467.76	81

Në Figurën 8 është paraqitur pjesëmarrja e secilës kategori në buxhetin total të rajonit zhvillimor Qendër, duke bazuar përqindjet mbi kontributin e MZHR-së.

Figura 8: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Qendër



Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Veri

Rajoni zhvillimor Veri ka përfituar 14% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur 28 projekte në kuadër të tre kategorive kryesore: Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në këtë rajon arrin mbi 423 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 343 mijë euro (81%) janë financuar nga MZHR,
- Ndërsa mbi 80 mijë euro (19%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 10: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor: Veri sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	12	57,672.50	4,533.50	62,206.00	15
<i>Lot 1</i>	11	150,569.42	36,799.67	187,369.09	29
<i>Lot 2</i>	5	134,880.00	39,420.00	174,300.00	25
<i>Totali:</i>	28	343,121.92	80,753.17	423,875.09	69

Figura 9 tregon pjesëmarrjen e secilës kategori në buxhetin e ndarë për rajonin Veri.

Figura 9: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Veriu



Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Perëndim

Rajoni zhvillimor Perëndim ka përfituar 12% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur gjithsej 22 projekte, të ndara në tri kategori kryesore: Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në rajonin Perëndim arrin në mbi 420 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 312 mijë euro (rreth 74%) janë financuar nga MZHR,
- ndërsa mbi 108 mijë euro (rreth 26%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 11: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Perëndim sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	9	42,262.00	3,654.00	45,916.00	18
<i>Lot 1</i>	7	96,400.00	25,115.00	121,515.00	13
<i>Lot 2</i>	6	173,800.00	79,430.00	253,230.00	18
<i>Totali:</i>	22	312,462.00	108,199.00	420,661.00	49

Në Figurën 10 është paraqitur shpërndarja e mjeteve financiare sipas kategorive për rajonin zhvillimor Perëndim, duke bazuar përqindjet mbi kontributin e MZHR-së.

Figura 10: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Perëndim



Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Jug

Rajoni zhvillimor Jug ka përfituar 16% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur gjithsej 34 projekte, të ndara në tri kategori kryesore: Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në rajonin Jug arrin në mbi 559 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 435 mijë euro (rreth 78%) janë financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR),
- ndërsa mbi 124 mijë euro (rreth 22%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 12: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Jug sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	10	46,309.00	4,124.93	50,433.93	15
<i>Lot 1</i>	18	233,676.40	62,058.40	295,734.80	36
<i>Lot 2</i>	6	155,098.40	58,629.10	213,727.50	25
<i>Totali:</i>	34	435,083.80	124,812.43	559,896.23	76

Figura 11 tregon shpërndarjen e mjeteve financiare sipas kategorive për rajonin zhvillimor Jug, duke bazuar përqindjet mbi kontributin e MZHR-së.

Figura 11: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Jug



Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Juglindje

Rajoni zhvillimor Juglindje ka përfituar 11% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur gjithsej 19 projekte, të ndara në tri kategori kryesore: Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në rajonin Juglindje arrin në mbi 384 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 286 mijë euro (rreth 75%) janë financuar nga MZHR,
- ndërsa mbi 97 mijë euro (rreth 25%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 13: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Juglindje sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	7	31,848.20	3,167.80	35,016.00	19
<i>Lot 1</i>	5	70,350.00	20,167.00	90,517.00	10
<i>Lot 2</i>	7	184,638.75	74,044.25	258,683.00	25
<i>Totali:</i>	19	286,836.95	97,379.05	384,216.00	54

Figura 12 tregon pjesëmarrjen e secilës kategori në buxhetin e ndarë për rajonin Juglindje, duke bazuar përqindjet mbi kontributin e MZHR-së.

Figura 12: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Juglindje



Raporti përmblledhës për rajonin zhvillimor Lindje

Rajoni zhvillimor Lindje ka përfituar 13% të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur gjithsej 26 projekte, të ndara në katër kategori kryesore: Start-Up – Student, Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në rajonin Lindje arrin në mbi 404 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 324 mijë euro (rreth 80%) janë financuar nga MZHR,
- ndërsa mbi 79 mijë euro (rreth 20%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 14: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Lindje sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up - Student</i>	1	4,945.00	-	4,945.00	1
<i>Start Up</i>	10	49,800.00	4,845.00	54,645.00	14
<i>Lot 1</i>	10	130,492.50	31,027.50	161,520.00	19
<i>Lot 2</i>	5	139,500.00	44,000.00	183,500.00	14
<i>Totali:</i>	26	324,737.50	79,872.50	404,610.00	48

Figura 13 tregon pjesëmarrjen e kategorive në buxhetin e ndarë për rajonin Lindje, duke marrë parasysh vetëm kontributin e MZHR-së

Figura 13: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Lindje



Raporti përmbledhës për rajonin zhvillimor Jugperëndim

Rajoni zhvillimor Jugperëndim ka përfituar një pjesë të rëndësishme të buxhetit total të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2024. Në këtë rajon janë mbështetur gjithsej 21 projekte, të ndara në tri kategori kryesore: Start-Up, Lot 1 dhe Lot 2 - biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve të financuara në rajonin Jugperëndim arrin në mbi 410 mijë euro, prej të cilave:


- mbi 318 mijë euro (rreth 77%) janë financuar nga MZHR,
- ndërsa mbi 92 mijë euro (rreth 23%) janë kontribuar nga vetë përfituesit.

Tabela 15: Shpërndarja e mjeteve financiare në rajonin zhvillimor Jugperëndim sipas kategorive biznesore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	6	27,980.00	2,490.86	30,470.86	9
<i>Lot 1</i>	10	143,868.40	29,915.60	173,784.00	27
<i>Lot 2</i>	5	146,212.50	60,037.50	206,250.00	14
<i>Totali:</i>	21	318,060.90	92,443.96	410,504.86	50

Figura 14 tregon pjesëmarrjen e kategorive sipas kontributit të MZHR-së në buxhetin e ndarë për rajonin Jugperëndim

Figura 14: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor Jugperëndim



Përfundimi

Ky program ka kontribuar në zhvillimin e rajoneve më të pazhvilluara të Kosovës, duke ndihmuar në forcimin dhe rritjen e bizneseve mikro dhe të vogla që operojnë në këto zona. Përpjekjet për të vazhduar dhe përmirësuar këto investime janë thelbësore për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të vendit.

Shuma e mjeteve të dedikuara për këtë qëllim ishte e konsiderueshme, dhe përfituesit kryesorë ishin bizneset lokale që arritën të rrisin kapacitetet e tyre operationale, të zgjerojnë aktivitetet dhe të rrisin numrin e të punësuarve. Në veçanti, mbështetja financiare e programit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e bizneseve me potencial për rritje, si dhe në përmirësimin e ofertës prodhuese dhe shërbyese në nivel rajonal.

Në bazë të objektivave të parashtruara në fillim të programit, arritjet kryesore përfshijnë:

Përkrahjen e bizneseve me potencial të lartë për rritje dhe forcim;

Mbështetjen e bizneseve që kontribuojnë në zvogëlimin e varësisë nga importet, megjithëse me ndikim të kufizuar;

Zvogëlimin e papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, veçanërisht për të rinjtë.

Megjithatë, programi përballlet edhe me sfida që kërkojnë adresim për të maksimizuar efektivitetin e tij në të ardhmen.

Për të përmirësuar implementimin dhe rezultatet e programeve të ngjashme, rekomandohet:

Përforcimi i kapaciteteve institucionale: Forcimi i institucioneve përgjegjëse për monitorim dhe zbatim për të siguruar një mbikëqyrje më efektive dhe një realizim të suksesshëm të projekteve.

Përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit: Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare, partnerëve ndërkombëtarë dhe sektorit privat për të përshpejtuar dhe lehtësuar realizimin e projekteve.

Përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe monitorimit: Përdorimi i sistemeve moderne për menaxhimin e informacionit dhe vlerësimin e ndikimit për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna.



Mbështetje financiare dhe fiskale për bizneset: Krijimi i lehtësirave financiare dhe tatimore për sektorin privat, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të reja, që të mund të zhvillohen dhe të kontribuojnë më shumë në ekonominë vendore.

Në përfundim, zhvillimi rajonal i balancuar mbetet një prioritet strategjik për përmirësimin e mirëqenies dhe standardeve të jetesës në Kosovë. Mbështetja e vazhdueshme për bizneset lokale, veçanërisht ato me potencial të lartë, është thelbësore për rritjen ekonomike dhe reduktimin e pabarazive rajonale.